



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA



06-05-2014

Nr. i Organizimit / Org. broj	Numërbroji	Shprehja	Lera / Vlerësimi
01-013/603			

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality of Viti/

Në bazë të nenit 12.2 shkronja d) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazetës Zyrtare nr. 28/2008, nenit 8 pika 2 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së pa luajtshme të Komunës nr 04/L-144 dhe nenit 36.2 shkronja d) së Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr. 013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancën e mbajtur më 29.04.2014, aprovon këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës së pa luajtshme të komunës në shfrytëzim

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi i Komunës së Vitisë, FORMON Komisionin vlerësues dhe zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së pa luajtshme të Komunës së Vitisë.

Komisioni ka 7 (shtatë) anëtar: tre nga ekzekutivi, tre nga Kuvendi i Komunës dhe një nga shoqëria civile dhe atë

1. Hidajete Aliu – anëtare e komisionit - juriste,
2. Mifail Azizi – anëtar i komisionit - ekonomist,
3. Arben Sahiti – anëtar i komisionit - gjeometër,
4. Samet Idrizi – anëtar i komisionit – anëtar i Kuvendit,
5. Xhylsime Qamili – anëtare e komisionit – anëtare e Kuvendit,
6. Sejdi Emini – anëtar i komisionit – anëtar i kuvendit dhe
7. Ibrahim Sefedini – anëtar i komisionit – nga shoqëria civile.

Neni 2

Detyrat e Komisionit nga neni 1 i këtij vendimi janë të përcaktuara në Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës nr 04/L-144 të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Komisioni udhëheq procedurat mbi vlerësimin e ofertave dhe mbikëqyr të gjitha punët në lidhje me dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës së Vitisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Anëtarëve të komisionit
2. DKPGJ-së,
3. Arkivit

